



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI B

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Teknologji e thelluar

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11a	11b	12a	12b	13a	13b	14a	14b	14c	15a
Pikët										
Kërkesa	15b	16a	16b	17	18a	18b	19a	19b	20	
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Kur koni i drejtë pritet nga një rrafsh pingul me bazën figura e ndërprerjes është. **1 pikë**
- A) Rreth
 - B) Drejkëndësh
 - C) Parabolë
 - D) Elips
2. Mbrojtja nga rënia në tension realizohet: **1 pikë**
- A) Me anë të nulifikimit mbrojtës
 - B) Me anë të vendosjes së kutisë së shpërndarjes
 - C) Me anë të vendosjes së kutisë së citofonise
 - D) Me anë të vendosjes së sistemit të ventilimit
3. Rrethoni përgjigjen e saktë: **1 pikë**
- A) kollonat shërbejnë për transmetimin e ngarkesave të marra nga ndërkatet dhe ia transmetojnë atë themelit
 - B) kollonat nuk janë elemente konstruktive të ndërtesës
 - C) kollonat janë elemente të skemave kinematike
 - D) kollonat janë elemente të skemave elektrike
4. Format i më i madh i përdorur në vizatim është: **1 pikë**
- A) A4
 - B) A3
 - C) A0
 - D) A5
5. Transporti që përdoret më shumë në vëndin tonë është: **1 pikë**
- A) Hapsinor
 - B) Ujor
 - C) Tokësor
 - D) Ajror
6. Ngjitja bën pjesë në: **1 pikë**
- A) lidhjet e zbërthyeshme të dy detaleve
 - B) lidhjet e pazbërthyeshme të dy detaleve
 - C) transmesionet me zinxhirë
 - D) bashkuese mekanikë
7. Minierat bëjnë pjesë në: **1 pikë**
- A) industrinë e lehtë
 - B) industrinë e rëndë dhe përpunuese
 - C) industrinë ushqimore
 - D) sistemet teknologjike
8. Rrjedhshmëria është: **1 pikë**
- A) Aftësia e metalit të shkrirë për të mbushur një formë
 - B) Aftësia e metalit për të punuar në të nxehtë
 - C) Aftësia e metalit për të punuar në të ftohtë
 - D) Aftësia e metalit për të ndryshuar strukturën kur ftohet.

9. Materialet që mendohen të përdoren më shumë në të ardhmen do të jenë: **1 pikë**
- A) Materialet qeramike
 - B) Kompozite
 - C) Polimeret
 - D) Metalet e zeza
10. Transporti me tuba bën pjesë në transportin: **1 pikë**
- A) Ujor
 - B) Hapsinor
 - C) Tokësor
 - D) Ajror
11. Dy rule cilindrike me fërkim kanë largësinë midis boshteve paralele 225 mm.
- a) Përcaktoni diametrat e këtyre ruleve për raportin e transmesionit $i=0.5$ **1 pikë**
- b) Vizatoni skemën kinematike të këtij transmesioni **1 pikë**
12. Saldimi është një metodë e bashkimit të detaleve që përdoret gjerësisht në praktikë.
- a) Duke e trajtuar si sistem teknologjik përcaktoni pjesët përbërëse të inputit. **1 pikë**
- b) Analizoni procesin teknologjik në këtë sistem teknologjik. **2 pikë**

13. Në industrinë mekanike sistemet e fuqisë së fluidit janë të përhapura dhe shumë të rëndësishme

a) tregoni një përdorim praktik të tyre

1 pikë

b) rendisni disa nga anët pozitive të këtyre sistemeve.

1 pikë

14. Për prodhimin e energjisë elektrike shërbejnë sisteme teknologjike që shfrytëzojnë energji të llojeve të ndryshme të burimeve natyrore.

a) Përmendni sistemet kryesore që përdoren në vendin tonë

1 pikë


b) Cilat mund të jenë burimet alternative që mund të përdoren në të ardhmen për prodhimin e energjisë elektrike në vendin tonë.

1 pikë

c) Argumentoni rëndësinë e lëndëve djegëse për ekonominë e një vendi

1 pikë

15. Të skicohet projeksioni ortogonal i prizmit të drejtë me bazë trekëndore të brendashkruar në rrethin me rreze 2 cm dhe lartësi 4 cm.
- a) Ndërtimi i saj të shoqërohet me 3 pamjet në ortogonal dhe me spjegime për elementët kryesore të saj. (Baza e prizmit është e mbështetur në horizontal)


3 pikë

- b) Të realizohet hapja e prizmit


1 pikë

16. Në figurë është dhënë piramida me bazë katërkëndore e prerë me një rrafsh të pjerrët.

a) Përcaktoni pikat e ndërprerjes së tyre në horizontal, vertikal dhe në anësor. **3 pikë**



b) Gjeni madhësinë reale të pjesës së prerë. **2 pikë**



17. Një nga sistemet e mjeteve të transportit është edhe ai i drejtimit. Përcaktoni elementët kryesore të tij.
2 pikë

18. Në cilësinë e ushqimeve një rol të rëndësishëm luan edhe ambalazhimi i tyre.

a) Përcaktoni disa nga materialet që përdoren në ambalazhim

2 pikë

b) Tregoni rëndësinë e etiketimit të produkteve ushqimore

2 pikë


19. Jepen trupi si në figurë

a) Gjej dy pamjet në horizontal dhe vertikal.

2 pikë

b) Realizo prerjen me rrafshin prerës (si në figurë), duke ndjekur rregullat për vijëzimet dhe emërtimin e prerjes.

1 pikë



20. Në planimetrinë e apartamentit të mëposhtem vendosni skemën e ndriçimit elektrik sipas simbolikës së mësuar.

2 pikë

